

Lindita KARADAKU

BIBLIOTEKA

85H-32
K 31

Shpirti lakunq



SHTEPJA BOTUESE

KOHA

85H-32
K32

Lindita Karadaku

SHPIRTI LAKURIQ

BIBLIOTEKA E
BASHKIS TIRAKASTER
NR INV 35814

KTHIMI NË TOKËN E MJRË

Emri dhe mbiemri im janë e para lidhje me atë tokë të largët dhe të afërt që herët ma mësuam që quhej Kosovë.

Gjyshja ime thoshte se atje rritej gruri, se kishte ujë dhe se toka punohej me plug druri. Gjyshi im ishte burrë i fortë dhe nuk fliste kurrë për dhembje. Pengu i tij i madh ishte shtëpia e madhe në malin e Karadikut, (në vonë e mora vesh se quhej Karadaku i Shkupit) dhe lëndina ku kishin mbetur varret e gjyshërve ku nuk shkonte në kush.

Ikja e tyre nga ajo, toka e largët ishte makthi për të cilin askush nuk dëshironte të fliste; donin ta harronin dhe të fillonin jetën tjetër në një vend që quhej Shqipëri dhe ku thirreshin "kosovarë".

"Ti je kosovare", - thoshte gjyshja ime, nana ime, që iku 15 vjeç, nëpër natë nga toka e mirë, dhe nuk i pa më kurrë nanën, babën, motrën, vëllezërit, "gjininë".

Gjyshi im, kosovari i gjatë, i hollë, e thashë, ishte burrë i fortë dhe nguli rrënjë në tokën e re, duke mbjellë pemë dhe fëmijë në tokën e athtë të Myzeqesë. Por, atë burrin e fortë e mbyti dhembja dhe vdiq herët, duke lënë në kënetë jetinë vocërrakë që u rritën të shkurtër, të varfër dhe të shkullur nga rrënjët. Një prej tyre ishte im atë, që

punoit arat, martoi motrat jetime dhe ndërtoi një shtëpi me shumë pemë, ujë dhe dritë që kryqëzohej mes pemëve si atje larg...

Gjyshja ime me sy të kaltër dëshironte që në shtëpinë e re, të hynte nuse kosovare, nuse që të vinte nga njerëzit e ardhur nga toka e mirë. Dhe nëna ime, e ardhur nga toka e mirë, hyri nuse në shtëpinë me pemë, dritë dhe ujë...

Prindërit e nënës sime jetonin në një shtëpi buzë lumit Gjanicë, me shelje dhe kopsht. Gjyshja e gjatë dhe e fortë e la Kosovën pesë vjec dhe 91 vite të tjerë në Myzeqe ku kënetat shkurtonte burrat. Para se të vdiste, shkoit në fshatin e lindjes, Ilincë dhe gjeti gurin e lëndinës ku ulej fëmijë.

"Kosova është gjak", thoshte, "dhe gjaku atje shkonte deri në gju të kalit; po Kosova është e mirë".

Nana e fortë jetonte me pengun e prindërve të saj, që vdiqën rrugës për në Shqipëri dhe nuk ua dinte varret. Motra dhe tre vëllezërit e saj u rritën në jetimore dhe i vetmi kujtim për ta ishte rruga e gjatë, e frikshme, në tokë tjetër, në njerëz të tjerë...

Im atë e pa Kosovën për herë të parë në vitin 1981. Fshati Depsë ku kishte lindur dhe ishte rritur familja e tij kishte dy familje dhe shume varre, varret e Luftes së parë, e Luftës së Dytë, të të vrarëve prej serbëve, turqve, bullgarëve... të gjithë atyre që kishin shkelur, kishin vrarë dhe kishin ikur...

Im atë takoi të gjallët dhe të vdekurit, madje edhe ata që kishin pritur ardhjen e tij për të vdekur...

Në atë vit, Kosova rifillonte derdhjen e gjakut të ri...

Sonte, nëna ime, nusja kosovare që hyri në shtëpinë kosovare, më thotë se toka e mirë po "çet" gjak përsëri dhe se njerëzit prapë po ikin, ashtu, nëpër natë, nëpër frikë dhe makth.

Nëna ime nuk e kupton ç'do të thotë zgjidhje paqësore, integrim evropian, UCK; ajo thotë vetëm se gjaku përsëri po shkon në gju të kalit, se varrezat në Depsë dhe Jlinçë do të shtohen, se fëmijë të tjerë do të enden rrugëve më kujtimin e mjegullt të gurit të lëndinës dhe shtëpisë në mal.

Im atë, burri i fortë që mbijetoi në kënetën e Myzeqesë dhe ndërtoi shtëpinë me gurë të bardhë, thotë se të gjithë do të kthehen në tokën e mirë, plisat e tashëm dhe ata që e lanë atë atëherë kur baroti i hidhur ishte po kaq i hidhur sa tani.

Kosovarët e mi të urtë thonë se toka e mirë i thërret njerëzit e vet...dhe gjyshërit e mi betohen se do të kthehen atje, qoftë edhe nga vdekja...

Parathënie

-O Zot, pse më jep atë që s'mund ta kem?

-Sepse ti jeton mes të mundshmes dhe të pamundshmes.

-Pse më fal gjithmonë sende të ndaluara?

-Sepse midis ekzistencës dhe mallkimit ka vetëm sende të ndaluara.

-Atëherë, më fal një të ndaluar!

-Po të fal veten. Edhe unë jam i ndaluar!

MUROSJA E PERËNDESHËS

Sergei erdhi ne Tirane ne nje nga ditet e shtatorit, kur ende nuk kuptohej nese ishte vere apo vjeshte.

Shetiti pjesen e rendshme te qytetit dhe iu duk se nuk kishte shenja lufte. Megjithate per tu siguruar zgjodhi nje shtepi ne periferi, me nje oborr te madh te shtruar me gureza lumi dhe nje pus ne mes.

E zonja e shtepise, nje grua e vogel e veshur me te zeza, kishte mbjelle rreth e qark lule qe lulezonin pothuaj gjithe vitin. Sergei u perpoq ti shpjegonte se vajzes se

tij te vogel Palina i pelqenin shume lulet, por gruaja nuk kuptonte asnje fjale ne gjuhen e tij.

Atehere, ai i tregoi me dore nga femijet qe luanin ne rrugice dhe tha:

-Une, femije, vajze, Palina...

Gruaja pa njehere femijet, pastaj Sergein.

-Palina...emri...

Sergei beri me koke.

-Po,- qeshi gruaja,- vajza jote quhet Palina.

Sergei zgjati pese gishtat e njeres dore dhe pastaj kater gishta te dores tjeter.

-Nente vjec eshte? - pyeti gruaja.

Sergei beri me koke.

Pastaj beri me dore nga lulet dhe tha shkurt:

-Lule, Palina...

Gruaja keputi gjithë trëndafilat që kishin celur dhe ia zgjati. Sergeit mori lulet, bëri me dorë mirupafshim dhe

ngjiti shkallet e drunjtë që kercisnin rende nën hapin e

tij prej ushtaraku.

Gruaja perseriti ngadale emrin Palina dhe qeshi me vete.

Iu duk emer i cuditshëm si emer zogjsh. Mori një dorë grure nga thesi i madh poshtë shkalleve dhe hapi derën e

kafazit të madh të pellumbave. Ata u derdhen vetetime duke rrezuar pertokë kokrrizat dhe u shperndane duke gugatur neper oborr. Gruaja mori një dorë tjetër grure dhe u ul tek shkalla e fundit. Pellumbat u sulen tek grushti i hapur, një pjese u ulen në prehrin e saj, ndërsa të tjeret moren nga një kokrize dhe u ulen neper guricka.

Sergei hapi dritaren pergjysem dhe hodhi në oborr një dorë biskotash të grimcuara.

Pellumbat u sulen duke krijuar një re të bardhë puplash dhe kraresh. "Mjafton të kesh grure se pellumbat vine vete", tha me vete Sergei.

Mbylli dritaret dhe filloi të hapte valixhet. Vuri në mur portretin e madh të Palines dhe ndezi cigaren e pare për
ate dite.

Gruaja ishte mbeshetur ne krahët e divanit dhe po dremiste me sy gjysem te mbyllur. Muzgu hijezonte lehtë dhomën me kolltukë të mëdhenj dhe perden ngjyre bakri të

çelët.

Gruaja degjoi turbullt zilen e telefonit dhe u ngrit me pertese.

-Allo...

Nje ze femije peshperiti disa here "Allo", pastaj e mbylli. Gruaja veshi me mundim pandoflat e zbriti shkallet. Dritaret e katit te pare te shtepise ishin hapur dhe nje grua me floke te verdhe dhe sy shume te kalter po nderronte perdet. Nje femije rreth te nentave,

qendronte ne parmak dhe pyeste pa pushim ne nje gjuhe qe

gruas iu duk si muzike romesh.

Vajza pa gruan dhe tha dicka duke qeshur. -Palina..., - i bertiti gruaja flokeverdhë duke e kercenuar me gisht.

Vajza qeshi prape duke treguar me gisht floket e gruas me të zeza qe ishin bere si kacuba pylli.

Gruaja u afrua tek dritarja dhe pershendeti lehte me koke. Flokeverdha buzeqeshi dhe tha dicka ne gjuhen e saj ndersa vajza tregoi me gisht veten, duke peshperitur "Palina"....

Flokeverdha i tha te pushonte dhe i bëri me shenjë gruas

të hynte brenda.

Gruaja hyri ngadale dhe u ul ne kanapen ne

qoshe. Nxori nga xhepi i perpareses paketen e cigareve dhe ia zgjati flokeverdhës. Gruaja e re u ul perballe dhe i foli dicka

Palines. Vogelushja mori nje cakmak nga tavolina dhe pa nga gruaja që i beri me shenje t'ia ndizte cigaren guas. Palina iu afrua ngadalë si macja zogjve të hutuar dhe ia vuri cakmakun pa e ndezur tek floket duke qeshur me te madhe.

Gruaja u cua ne kembe, po vajza kishte fluturuar.

Zonja plakë i bëri me shenjë flokëverdhes të mos shqetësohej dhe u cua duke tërhequr pantoflat.

Hapi ngadalë deren e dhomes se vajzes dhe qendroi nje hop. Palina u fsheh ne dollapin e rrobave dhe mbylli fort deren nga brenda. Gruaja u ul ne karrigen e vogel perballe shtratit dhe peshperiti ngadale emrin e saj.-Polina..Polina...

-"Palina"-, bertiti vajza nga brenda dollapit.

-Polina,jo Palina, - tha gruaja duke buzeqeshur.

Vajza u nxeh. Doli nga dollapi dhe qëndroi perballe saj ne pozicion sulmi.

Palina...

Zonja plakë nxori nga xhepi i perpareses një ëngjëll te vogel te bardhe te punuar ne gur dhe ia zgjati. Vajza nguroi nje cast në mëdyshje, pastaj zgjati doren. Gruaja

e uli ngadale ne preher duke i lemuar floket ngjyre hekuri te prera drejt.

Palina nxori cakmakun dhe i ndezi cigaren guas. Pastaj mori kreherin dhe filloi te krihte ngadale floket e ngaterruara, duke i shtruar me dore.

Tregoi ikonën e vogel mbi shtratin e saj.

-Maria,- tha ngadale.

Gruaja beri "po" me koke ndersa vajza vuri ëngjëllin prane ikones.

Muzgu kishte rene plotesisht dhe ëngjëlli i bardhe shpërbëhej mbi figuren e Zonjes Shen Meri.

Zonja plakë jetonte vetëm prej kohësh. Shtëpia ishte tepër e madhe dhe ajo shkellte lehtë si për të mos prishur paqen e qiellitë. Cdo mëngjes pinte kafe përballë portretit të papërfunduar të një vajze të vogël të mermertë, e ulur në kolltukun në krah të dritares së madhe, nga dukej kopshti dhe priste vajzën e vogël që zbriste shkallët e drunjta me zhurmë për të lajmëruar ardhjen e saj. Vajza thoshte cdo ditë nga një fjalë të re në gjuhën e gruas dhe i shpjegonte kuptimin në gjuhën e vet. Palina prekte c'të mundëj, prishte, ndreqte ndërsa gruaja plakë mrekullohej.

Një ditë, e pyeti për vajzën e vogël në mermer.
Gruaja u

cua me mundim dhe i bëri me shenjë ta ndiqte. I tregoi në sallon një portret në vaj të një vajze rreth të njëzetave, e veshur me një lloj veshje të bardhë, pa formë, që derdhej trupit të mjegullt.

-Dea...kjo është Dea-, tha duke treguar me njëren dorë vajzën në portretin në mur dhe vajzën në mermer.

Vajza e vogël pa me cudi. Përsëriti ngadalë

emrin dhe vështroi zonjën plakë duke pritur shpjegime.

-Dea ishte hyjneshë...

Palina nuk e kuptoi.

-Bijë e zotit, - tha gruaja.

-Caresha, - tha Palina.

Gruaja qeshi.

-Jo, jo, perëndeshë....

Copa e madhe e mermerit qëndronte në mes të dhomës. Një kokë fëmije ishte gdhendur me kujdes ndërsa trupi dukej ende i papërfunduar. Gishtat e këmbëve kishin mbetur të gdhendura pjesë-pjesë ndërsa shpatullat ishin më të gjera seç duhet të kishin qenë në të vërtetë.

Dea mori daltën dhe e la përsëri.

-Nuk e di pse e kam kaq të vështirë ta punoj, - tha duke

psherëtirë.

Gruaja nuk e dëgjoji. Kishte marrë shallin e madh dhe po mbështillte këmbët.

-Davidi duhet të kishte ardhur, - tha si duke folur me vete.

Vajza qeshi.

-Mamina, gjithë bota jote rrotullohet tek Davidi. Po të mos jetë ai, ti strukesh, bëhesh një grusht njeri.

Gruaja buzëqeshi. "Puno", - i bëri me shenjë.

-Mamina, nuk e prek dot këtë mermer. Më mirë

të mbetet sic e ka lënë axha.

-Më mirë...ashtu - përsëriti gruaja dhe lëmoi me gishtat

e hollë dhe të gjatë kokën e gdhendur.

Dea u mbështet në supin e saj dhe tërhoqi pak shallin, për të mbuluar këmbët.

-Mamina, të kujtohet kur rrija tek axha të shtunave... ulesha tek divani i vjetër dhe ai qëllonte me daltë mermerin...

Gruaja ia mbështeti kokën në kraharor. Flokët e vajzës binin mbi shpatulla dhe rrëzoheshin në hijëzimet e trupit.

-Kush ishte axha mamina?, - pyeti vajza.

Gruaja nuk foli.

Davidi hyri duke dëgjuar vetëm pyetjen. Kaloi me kujdes,

sikur të kishte frikë se mos prekte figurinën e gdhendur

dhe puthi gruan.

-”Më duket sikur ka mbetur i nguajar aty në mermer....”,

mërmëriti vajza.

Dea zgjati duart drejt kokës së shtratit, ktheu pakëz kokën nga komodina e vogël dhe bëri një shenjë puthjeje me buzë.

-Mamina, të kam parë në ëndërr.

-Si, - pyeti gruaja me flokë të gjatë, e ulur në anë të shtratit.

-Ti po kërkoje qiellin me sy dhe me duar, po ai nuk ishte asgjëkund.

Gruaja vuri buzën në gaz. Shtriu mbulesën për të mbrojtur supet e imtë të vajzës nga ajri i freskët dhe mbështeti kryet në anë të murit.

-Mamina. Ti je e cuditshme, prandaj shoh ëndrra të cuditshme me ty,- tha vajza.

Gruaja ia mori duart dhe ia mblodhi në pëllëmbë: Ia puthi lehtë dhe ia fshehu nën mbulesën me zogj dhe ëngjëj të vegjël.

-Kështu ke qenë gjithmonë mamina, kështu...e mirë...

Gruaja e pa në sy dhe qeshi.

-Të kujtohet mamina, kur isha e vockël fare...

-E vogël je akoma..., - qeshi gruaja, - madje tani më dukesh më e vogël....

Vajza mori mjelmën e varur mbi krevat dhe e vuri mbi trupin imcak.

-Mamina, kush ishte Dea?-, pyeti vajza.

Gruaja e pa me habi.

-Dea?! Sigurisht që ishte vajza më e bukur e qytetit.

-Më e bukura, më e bukura fare?

-Po, më e bukura e të bukurave....

-Po pse hyri në mermer?, - pyeti vajza trishtueshëm.

Gruaja e pa qetësisht dhe foli me zë të ulët: - Sepse ishte aq e mirë sa perënditë e deshën për vete dhe nuk ua lanë njerëzve.

Vajza pa disi me cudi perëndeshën sikur të donte

të bindej se ajo ishte “aq e mirë” dhe drejtoi dockën drejt

figurinës së mermertë.

Perëndesha i kishte sytë të lëngët. Gruaja mendoi për një cast lëngun e bardhë të kërcenjve të bimëve që këputeshin dhe afroi Dean pranë vajzës.

-Dea, c’i ndodhi vajzës së mermerit?

-Po qan mamina, po qan...

Gruaja u trishtua. Lotët e perëndeshës treteshin brenda mermerit të bardhë dhe asaj iu duk se nusja e ëmbëlth po

vajtonte vetminë e stërmadhe. Vajza e vogël i shpëtoi nga duart dhe rendi drejt derës duke vrapuar me këmbkat e vogla, të zbathura.

-Dea te mermeri po qan, po qan Dea te mermeri, - thërriste duke përshkuar shkallët, koridoret dhe dhomat e heshtura.

Ai i dëgjoji i shtangur thirrjet e vajzës, duke kuptuar vetëm se dikush me emrin Dea po qante.

Hapi derën e studios ndërsa vajza iu hodh në krahë duke u ngatërruar në fustanin e gjatë të natës.

-Dea e mermerit po qan...edhe mamina po qan me Dean...

Ai e mori vajzën në krahë dhe eci ngadalë drejt dhomës së vogël.

Gruaja vazhdonte të qëndronte e ulur në cepin e shtratit.

Ai e lëshoi vajzën në krevatin e bardhë dhe u ul lehtë sikur të donte të mos prishte qetësinë e

dhomës.

-C'ndodhi Rozelë?

Gruaja nuk foli. Lëvizi pak dhe u mbështet pas tij.

-C'ndodhi Rozelë?, - pyeti ai për herë të dytë.

Gruaja e pa drejt në sy sikur të donte të hynte brenda tyre. Atij iu duk se shikimi dhe heshtja do ta ngurtësonte gruan duke e kthyer në një figurinë të mermertë.

-M'u kujtua historia e lashtë, ti ma ke treguar dikur në Butrint...

-Po, - u përgjigj ai i çliuar.

Sytë e gruas u bënë të ndritshëm.

-Pata frikë, nuk e di pse pata frikë...m'u duk se gjithcka do të mbetej brenda meje si tek nusja e mermerit...

-Mamina, ti i ngjan nuses së mermerit, - tha vajza, duke

parë herë gruan dhe herë figurinën e perëndeshës.

-Dhe pata frikë me të vërtetë, - vazhdoi ajo, sikur të mos e kishte dëgjuar vajzën, - pata frikë se do të mbetesha e vetme përjetësisht, si ajo vajza e bukur e Butrintit në gur....

Burri shtangu.

-Ne ishim bashkë Rozelë...

Gruaja uli sytë si në një ndjenjë faji.

-Po..., por u ndjeva vetëm në atë ngurtësim njerëzish...

Palina dëgjonte me kokën mbështetur në duar.

-Po pastaj...

Zonja plakë ndezi cigaren dhe priti derisa tymi u davarit.

“Ata ecnin të tre në një rrugë të ngushtë, me pemë anash

që kryqëzoheshin, duke krijuar mbi kokat e tyre figura të cuditshme. Dea anohej herë nga njëri dhe herë nga tjetri, duke pëshpëritur pyetje që merrnin përgjigje të shkurtra.

Gruaja ngrinte herë pas herë fundin e gjatë ndërsa burri

mbante fort dorën e fëmijës, që përpiqej t’i shpëtonte për të ecur përpara.

-Mamina, do të m’i krehësh flokët si të Deas, - pyeti vajza një cast, pa arritur të shkëputej nga dora e të atit.

Burri qeshi nën buzë, duke parë me bisht të syrit Rozelën.

-Po shpirt i vogël, kur të shkojmë në shtëpi.

Vajza turfulloi duke ngulur këmbët fort në trotuar.

-Ti më the edhe dje mamina...

Vajza shpejtoi hapat dhe filloi të mërmëriste një këngë të pakuptueshme. Davidi ia lëshoi dorën dhe e vogla vrapoi përpara drejt fundit të rrugës ku shiste misra të pjekur një plak i dobët, i kërrusur si trung i vjetër.

-Axha, axha, - thirri e vogla, duke i thirrur



plakut në emrin që i kishin vënë fëmijët e shkollës përbri.

-Axha, më jep një misër të vogël.

Plaku e afroi lehtë me dorë dhe e uli në prehër.

-Cilin don?

Vajza pa me vëmendje kallinjtë që piqeshin në prush, duke u munduar të zgjidhte më të madhin.

Plaku zgjati dorën drejt tyre dhe e pyeti përsëri.

-Cilin don?

Dea pa në sy plakun sikur të kërkonte ndihmë.

-Ma len ta zgjedh un, - i tha plaku.

E vogla nuk kundërshtoi. Plaku mori njërin prej kallinjve, e mbështolli me një copë letër të pastër dhe ia vuri në dorë.

Davidi nxori një kartmonedhë dhe ia zgjati plakut.

Ai rrëmoi në grumbullin e qindarkave të hedhura pa kujdes në një kuti kartoni, por Davidi nuk e la të nxirrte gjë prej andej.

-Mbaji, mbaji.

Plaku e pa në sy me një shikim të trishtë.

Mori një kalli tjetër nga prushi dhe ia zgjati Rozelës.

Gruaja vuri buzën në gaz.

-A po mundesh?, - e pyeti.

Plaku përzjeu prushin me mashë dhe rrotulloi misrat e pjekur në njërin krah.

-Po, se s'mundem ndryshe..., - tha duke i ndarë fjalët një nga një.

Gruaja e pa në sy sikur të donte t'i thoshte, "të

gjithë

e shtyjnë se s'munden ndryshe”.

-Tash nuk mundem me ble as duhan të mir...

Rozela hapi cantën, mori paketën dhe ia zgjati.

-Jo, - bëri plaku me dorë, - jo.

Gruaja ia zgjati përsëri. Shikimi i saj ishte i cuditshëm, saqë plaku e kapi pa vetëdije paketën, mori një cigare dhe i zgjati edhe një asaj.

Davidi u ul në parmakun e shkollës ndërsa Rozela u mbështet tek shkallët. Vajza vazhdonte të rrinte në prehrin e plakut, duke ngrënë kallirin.

-M'shkon dita ktu, - tha plaku, - m'shkon edhe gjysma e natës. Kur shkoj në shtëpi, coj vec qindarka, kurgja tjetër.

Gruaja ktheu kryet butësisht.

-Unë coj vetëm veten në shtëpi ndërsa Davidi gjithcka tjetër.

Plaku nuk qeshi. U mbështet fort pas kangjellës.

-Asht e randsishme me cu vedin n'shtëpi, m'beso, asht e randsishme, sidomos për një burrë asht e randsishme.

Gruaja nuk foli. Uli kokën prapa për të hequr nga fytyra

flokët që i kishin rënë dhe qeshi.

-Kur ha unë, hanë edhe flokët, - tha duke shpërndarë një

aromë të brishtë si bajame të pjekura.

Davidi zgjati dorën dhe hoqi kallinjtë e pjekur. I vuri mbi mbulesën e pastër dhe mori kallinjtë e tjerë në shportë.

- Blejnë njerëzit misra axhë?

-Ktu po blejnë, - u përgjigj plaku duke treguar me dorë vajzën.

-Fmijtë blejnë...m'japin dicka, - shtoi me zë të ulët.

Gruaja mbështolli kallirin bosh me një copëz letre dhe e

vuri në anë të parmakut.

-Ai fëmija i prapë, nuk vjen më axhë...

Plaku nuk foli. Trazoi përsëri prushin me mashë.

-Ai kish ma shumë pare se fmijtë e tjerë, ma shumë se unë që shes kallij...

Davidi i vuri duart mbi shpatulla dhe i bëri me shenjë vajzës të cohej.

-U lodhe duke e mbajtur në gjunjë axhë...

Plaku e pa me trishtim.

Vajza nuk u cua. U mbështoll pas plakut dhe pa me bisht të syrit Davidin.

Rozela u ngrit në këmbë, rregulloi përsëri fundin dhe i zgjati dorën Deas.

-Hë kukull, si thua, do të shkojmë në shtëpi...

E vogla u cua ngadalë, si me përtesë. E puthi plakun në faqe, ia bëri me dorë mirupafshim, dhe i zgjati dorën gruas.

-Axha, po ikim ne se mamina lodhet shpejt...

Gruaja buzëqeshi. Davidi u përkul dhe e mori vajzën në krahë.

-Pse nuk zgjodhe vetë Dea?

-Cfarë?, - pyeti vajza përgjumshëm.

-Lëre, po e zë gjumi, - foli Rozela me zë të ulët.

Davidi e vështroi gruan butë dhe e puthi lehtë në qafën e gjatë, të zbuluar.

Rozela qeshi.

-Ti...

Davidi e puthi përsëri gruan ndërsa Dea kuturisi me kokën mbështetur në krahë e tij.

-Sh'ke turp...babi sh'ka turp, - i pëshpëriti gruas.

Vajza zgjati duart dhe bashkoi kryet e tyre.

-Pufe ti mamina...

Burri e shtrëngoi fort në krahë ndërsa gruaja qeshte, sic nuk kishte qeshur prej kohësh.

Plaku i pa edhe njëherë nga larg dhe mblodhi kallinjtë bashkë, të pjekur dhe të papjekur.

-Nuk vjen ma kush, - mermëriti, - ata janë të fundmit që

vinë te unë....

Hodhi ngadalë cantën e vjetër ngjyrë hiri në sup dhe mori rrugën e kthimit. Atje, s'pret kush, foli me vete, atje presin vec muret....

-Po të prisja Palina, - tha gruaja duke pirë pa zhurmë kafënë e mbetur në filxhan.

Vajza mbështeti kukullën në divan dhe u ul duke shtrirë kembët.

-Ku shkoi axha pastaj?,- pyeti menjëherë.

Zonja plakë buzëqeshi. I zgjati Palinës kallirin e pjekur

dhe priti derisa vajza nisi ta grimconte kokrra kokrra.

“Plaku hapi derën me mundim. Rrugica ishte e errët dhe ai mezi gjeti vendin e celësit. Rënkoj një copë herë derisa

shkoi tek divani i vjetër me copë të zbardhlyt ngjyrë kafeje të pjekur shumë.

La cantën në një cep dhe u shtri rëndë në divanin që kërciti nën peshën e trupit.

-O zot,- mërmëriti, - sa vjet u bënë kështu, vetëm me vedin...

Ndenji një copë herë shtrirë pa lëvizur, pastaj zgjati krahun dhe mori cantën. Paketa e gruas së bukur, ishte vënë me kujdes në të vetmin xhep që kishte canta.

Plaku mori një cigare dhe i mori erë.

-E mirë...

Zgjati përsëri krahun, mori jastëkun dhe e vuri poshtë kokës.

-I cmendëm, kam kenë i cmendëm, si e lash me m'ikë...

U cua ngadalë, duke zgjatur këmbët mbi qilimin e shtruar

keq.

Shkoi tek soba, hapi derën e vockël dhe filloi të shtronte një nga një, në fillim ashkla të thata, pastaj letra të vjetra dhe drutë e prera trashë.

I vuri cakmakun dhe ndenji një copë herë duke parë sesi drutë merrnin zjarr njëri pas tjetrit me një flakë të bukur shumëngjyrëshe.

-T'kam dashtë shumë, - i tha flakës, - t'kam dashtë shumë, po nuk e kam ditë...

Mbylli derën e vockël dhe u ul përsëri në divan. Nxori nga canta një nga misrat e mbetur dhe filloi ta grimconte.

Përtypej me përtesë, duke parë sesi pikat e para të shiut strehoheshin në xhamin e të vetmes dritare të dhomës.

-Jan tuj u lagë, - tha me vete, - jan tuj u lagë krejt, vec zoti i ndihtë...

Me njëren dorë afroi batanijen duke mbuluar vetëm këmbët

„ndërsa me tjetrën mori kapucin që i kishte dhuruar vajza e vogël.

-Asht e bukur, asht ma e bukra e t'bukrave, - tha me zë dhe sakaq e zuri gjumi”.

Zonja plakë u ul ngadalë në anë të kolltukut dhe fshiu me dorë xhamin e dritares së avulluar nga nata. Shtriu këmbët dhe u mbështet duke lëshuar kokën mbrapa. Kopshti

i vogël ishte lagur krejt dhe degët e pemëve vareshin të mbushura me pikla uji.

Ndenji një copë herë duke parë me sy gjysëm të mbyllur drurët. Njerëzit kishin filluar ta pranonin

me përtesë ardhjen e dimrit. Mëngjeseve, hidhnin krahëve bluza me mëngë të gjata ose xhaketa të holla ndërsa në mesditë, shijonin me kryeneçësi lëngimin e fundit të verës. Ngrohtësia e diellit të verës përzihej me erën e ftohtë të dimrit. Zonja plakë thithte me gjithë mushkëritë ajrin e ftohtë të mëngjesit, duke iu gëzuar ardhjes së të ftohtit. Vera e bënte nervoze, i dukej se në verë nuk thithte ajër, por avuj të nxehtë përvëlues.

Kur moti ftohej, asaj i pëlqente të shëtiste herët në mëngjes ose vonë në mbrëmje bashkë me Davidin dhe Dean...

“Vajzës i pëlqente të flinte në mëngjes, por çohej menjëherë sapo Rozela i thoshte se ata do të dilnin. Vogëlushes nuk i pëlqente të zgjohej vetëm. Rozela mbështetej në krahun e Davidit ndërsa Dea përpiquej të kuptonte çfarë kishte ndodhur gjatë natës me rrugët, trotuaret dhe lulishtet.

Atë mëngjes, që të tre ecnin pa folur. Rruga për tek shtëpia e plakut ishte e gjatë dhe ata donin të ecnin në

këmbë si për të mbledhur veten. Vajza ecte dy hapa përpara, duke u penguar në trotuarin e prishur. Në rrugë

kishte pak njerëz dhe qyteti dukej si i zhytur nën një mjegullë të hirtë.

-Ndoshta duhej të kishim blerë dicka, - tha Rozela me zë

të ulët, duke u kujtuar se nuk kishin marrë asgjë me vete.

Davidi nuk foli. Eci disa hapa, pastaj ktheu kokën dhe mërmëriti, - “të shkojmë njëherë atje, pastaj shohim”.

Rozela nxitoi hapat. Ndaloi në shtëpizën e vogël në krye

të rrugicës, ku shiteshin ëmbëlsira dhe fruta. Të tre përshkuan me ngut rrugicën dhe si të ngrirë ndenjën një cast para shtëpizë së vogël me pemë, të plakut.

Dea kaloi nëpër rrugicën e vogël që ndante lehtë e luleve dhe trokiti tek dritarja.

Axha, axha....

Fytyra e plakut u duk një cast në xhamin e avulluar, pastaj tek dera. Dhoma dukej e mugët por e ngrohtë.

Plaku përqafoi me mundim Dean dhe shkoi drejt divanit, duke ua bërë me dorë Davidit dhe Rozelës që të hynin brenda. Davidi nxitoi ta ndihmonte të shtrihej, ndërsa gruaja mbylli derën dhe la çantën në cepin afër sobës.

-E fillove keq dimrin sivjet, - i tha Davidi dhe i buzëqeshi.

Plaku u kollit një copë herë me kokën nga muri, pastaj u

mbështet i lodhur me dorën në kraharor.

-Jam plak; s'ka faj dimri.

-Axha, ta rregullojmë pak dhomën?- pyeti Dea. Plaku i bëri me shenjë të ulej ndërsa Rozela qeshi.

-Mirë axhë, Dea le të rrijë me ty, kurse unë po rregulloj dicka sa të vijë Davidi,- tha.

Vajza u hodh mbi divan, tek këmbët e plakut.
Rozela vuri

tenxheren e vogël me ujë në zjarr, mbushi sobën
me dru dhe filloi të pastronte qilimin, duke dëgjuar
cfarë i thoshte Dea plakut.

-E di axha, mami i Drinës ka një bebe te barku,
një bebe

të madhe axha, se i është bërë barku kaq....

Plaku qeshi dhe u kollit përsëri.

-Vetëm maminat mbajnë bebe te barku axha, ë?
Plaku qeshi përsëri. Vajza nuk priti përgjigje,
po vazhdoi.

-Axha, pse rri vetëm ti?

Rozela ngriti kokën dhe i bëri shenjë vajzës të
pushonte.

Plaku nuk foli. Ia mori dorën Deas dhe ia puthi.

-Do vish me ne axha?

Plaku e pa me çudi dhe ktheu sytë nga Rozela.

-Po axhë, pse nuk vjen me ne?

-Kam lulet, kam kopshtin...

Dea u hodh nga divani dhe filloi të filloi të
kërcente nëpër dhomë.

-Axha, axha, hajde me ne axha, të lutem axha...

-Nuk muj....

Vajza iu afrua plakut duke e parë me bisht të
syrit si drenushë. Ia përkëdheli fytyrën me gishtat
e hollë.

-Axha, të lutem axha....

Rozela i bëri me shenjë Deas. Plaku po qante.
Lotët i rrokulliseshin në kërcenj të e fytyrës duke

lënë shenja si të rrënjëve të bimëve që kalben pa parë diell.

Rozela e mblodhi veten. Mori kupën e vjetër në raftin e librave dhe ia zgjati Deas.

-Duhet lule, kukullë. Do t'i këpusësh ti në kopësht?

Dea pa nga plaku, që i bëri me shenjë të shkonte.

-Nuk vonohem axha...

Rozela u ul në kolltukun me krahë të ngrënë nga bërrylat

e mbështetur në të prej vitesh dhe i zgjati një cigare plakut.

-Ti mund të rrish tek në axhë; Dea të do shumë...

Plaku nuk foli. "Ti e di që unë nuk shkulem prej këtu", thoshte vështrimi i tij.

-A mundeni me ma lanë vajzën ktu, të rrijë ndonjë ditë kur nuk ka me shku n'shkollë?

Rozela u shtang. U kthye një cast nga plaku, pastaj fiku

cigaren dhe u çua.

-M'fal. Ndoshta nuk beson se mundet me ndejt ktu...

-Çfarë të pëlqen të hash axhë?, - ia ktheu Rozela.

Plaku bëri me dorë, "çfarë të duash" dhe u mbështet në krah duke dëgjuar Dean që këndonte jashtë.

-Do të flas njëherë me Davidin axhë, - tha Rozela papritur.

Plaku ktheu kokën dhe buzëqeshi. Dera u hap me zhurmë. Dea hyri pothuaj duke vrapuar, dhe

pas saj, Davidi, me duart mbushur me ushqime dhe fruta. Rozela mori çantat dhe u kthye tek soba. Davidi u mbështet në ndenjësë dhe mori frymë thellë.

-Axe, ke qenë ndonjëherë në Butrint?

-Jo, - bëri plaku me kokë.

-Kur shkova për herë të parë, m'u duk si kishë e mermertë.

"Ku shpirtrat ishin ngurtësuar në mermer dhe gur", shtoi

Rozela me vete dhe ktheu sytë nga vajza, që po dremiste në krahë të Davidit.

-Dhe Dea hyri pastaj në mermer?, - pyeti vajza e vogël.

Gruaja u cua, mori në dorë skulpturën e pambaruar me një

ndjesi sikur do ti thyhej në cast duke u kthyer në mijëra copa guri të bardhë.

Puthi gishtat e pambaruar dhe vuri mbi sobë cajnikun duke përfytyruar për të disatën herë gjyqin e madh në Bibël...

"Dea ulej cdo të shtunë në mbrëmje në divanin e vjetër ndërsa plaku përballë në një stol të rumbullakët druri.

Mes tyre qëndronte mermeri i bardhë ku lodronin dritë hijet e kopshtit. Plaku shikonte ngultas tiparet e vajzës dhe i shkruante në gurin e

bardhë njërin pas tjetrit.

Rozela ia kishte krehur flokët vajzës si të nuses së Butrintit dhe Dea qëndronte në të njëjtin pozicion duke parë me sytë pakëz të ulur degën e qershisë që varej si kurorë mbi të vetmen dritare të dhomës.

Plakut i përllqente vecanërisht hunda e vogël dhe sytë e mëdhenj të vajzës me qerpikët që vareshin si strehëz.

Plaku shkëpuste grimca mermeri ndërsa vajza rrinte pa u ankuar deri në orët e vona të natës, kur gjumi e përumbte. Plaku vazhdonte të gdhendte, madje i pëlqente

më shumë kur e vogla dremiste, ashtu gjysëm në gjumë, gjysëm zgjuar.

Qënia e Deas kishte një dritë të përtejbotshme që plaku e hidhte në mermer, duke lagur me lotë pluhurin e bardhë të gurit.

-Mermeri është i keq, të bën gur, po maminës i pëlqen mermeri... - thoshte vajza.

Plaku ulte kryet dhe i binte më fort mermerit të bardhë,

derisa copëzat shpërndareshin nëpër dhomë dhe sytë i ndjente si të mbushura me guricka.

Afër mëngjesit, kur vajza flinte, ai ulej në kolltukun e

vetëm të dhomës dhe priste të zbardhej duke parë tiparet

e fëmijës që ndryshonin në lojën e dritës. Në mëngjes Rozela dhe Davidi hynin pa zhurmë. Plaku

me sytë si bërthama qershish nga lodhja u bënte shenjë të mos flisnin se “arratisej gjumi i të voglës”.

Palina preku lehtë gishtat e figurinës së papërfunduar. Zonja plakë u cua me mundim, hapi perdet dhe i bëri me shenjë. Vogëlushja iu afrua dritares. Macja kuqalashë po

ngrohej në rrezet e fundit të diellit të mesditës, mbështetur tek trangu i mollës në mes të kopshtit.

Vajza e tërhoqi lehtë.

-Ku është tani Dea?

Gruaja u ul e këputur në kolltuk. Mbështeti fytyrën në duar dhe qau pa zë dhe pa lotë derisa dielli u zhduk mes

krahëve të pemëve. Piu pothuaj një paketë cigare njëra pas tjetrës sikur të donte ta vriste veten ngadalë pa dhembje.

-Dalim Palina..., tha kur paketa bosh po digjej ngadalë me një flakë hollake në vatër.

Vajza zgjati dorën dhe priti derisa zonja plakë u cua mundimshëm në këmbë.

-Kam ecur këto kohë vetëm, pa i folur kujt dhe pa më interesuar kush. Doja harresë, askush të mos kujtohej më

për mua, si për një të vdekur që vetëm rastësisht sillet

nëpër jetë...

Vajza dëgjonte pa kuptuar asgjë.

-Palina, zoti nuk i lejon dashuritë që kalojnë kufijtë e

tij, dhe hakmerret...po më kalbet shpirti Palina...

E vogla e pa me druajtje.

-Cfarë është shpirti dhe kalbja?

Zonja plakë nuk foli.

-Jam në jetë dhe rroj me të vdekurit..., -
mërmëriti dhe

shpejtoi hapat. Palina e ndoqi pas duke shtrënguar në njërën dorë kukullën me sy të blertë.

Nata kishte kapëlyer bishtin e përdredhur të rrugicës dhe zonja plakë shpejtoi hapat...

"Nata ishte bërë e tejdukshme si vel I zi sperkatur me fijeza drite. Ne rruge kishte pak kalimtare dhe ne bujtina ishin rralluar njerezit. Pas pak fillonte ndalimqarkullimi.

-Njerezit jane si perandorite, lindin, lulezojne dhe shemben, tha Dea.

Zonja plakë heshti.

-Do te iki shume shpejt dhe do te jemi shume larg. Une do te jem ne anen tjeter te oqeanit, - foli vajza me zë të mbytur.

-Bota eshte e vogel...

-Si ka mundesi qe ne kete bote kaq te vogel te ndoshin tragjedi kaq te medha..., - tha Dea.

Gruaja heshti.

-Njerezit kryqezuan birin e Zotit. Bota e tere eshte mekatore përderisa vjen në jetë përmes

mëkatit,- tha Dea

nëpër dhëmbë dhe u çua”.

Zonja plakë pushoi një hap dhe ndezi cigaren.

“Netet treteshin brenda diteve dhe ajo nuk arrinte të kuptonte ku fillonte njera dhe ku mbaronte tjetra. Gjithcka kishte humbur drejtpeshimin. Koha rrotullohej me nje bosht te cuditshem qe quhej gjendje e jashtezakonshme. Njerezit u mesuan me gjakun si me nje perce te vjeter qe papritur kishte dale nga sendukët dhe varej e frikshme mbi shtëpitë dhe njerëzit.

Thone qe marrezise i vjen fundi kur mbaron se menduari i

mencuri. Por te mencurit vazhdonin te mendoheshin ndersa te marret si nje hordhi barbaresh shkaterronin c’gjenin perpara.

Syte e Deas kishin atë kohë nje drite te bute, te shperndare gjithandej dhe nuk e di pse me kujtonin liqenin para furtunes. Kishin nje perzierje ngjyrash, nuanca te grise, ngjyres kafe dhe te zezes. Ishte nje dhembje pa ngushellim, e ftohtë si ky guri i mermerit”.

Zonja plakë heshti përsëri. Capiti ngadalë deri në kuzhinë dhe bëri një filxhan tjetër kafe. Ndjeu nje zhurme ritmike si te hekurxhinjve qe rrahin hekurin. Levizi ngadale për të mos zgjuar Palinën që e kishte zënë gjumi në divan, dhe hapi dritaren.

Kishte filluar shiu. Shkurretat qe kishin mbire ne kopsht pas kalbjes se bimeve te veres po lageshin duke leshuar nje arome te papercaktuar,

nje shije e lagesht toke dhe barishtesh.

Pa oren dhe ndezi cigaren. Edhe pak ore dhe do te zbardhte. Dita qe prisja ishte boshe si nje teneqe e vjeter, e hedhur ne nje cep, qe nuk vlen me per asgje.

U mbulua me velenxën e trashë dhe u përpoq të mbyllte sytë.

Dea dergjej në njërin nga krevatet, me sy të fryrë. Nuk shihte, nuk lëvizte dhe nuk fliste. Rozela i jepte hërë pas here disa pika lëng potokalli përzier me ilace që ajo i gëlltiste me mundim. Trupi i ishte trefishuar nga sëmundja dhe në kokë kishte vëtëm disa fijëza të holla floku që kishin mbetur pas operacionit. Nga mesi i natës, frymemarja filloi t'i ngadalësohej dhe mezi mbushej me frymë.

Një moment, nuk arriti të kapërdinte ajrin dhe u cua pothuajse përgjysëm.

Davidi lutej në një cep të dhomës.

Ishte korrik. Nata ndriste e gjitha mbi pellgun e nogël të ujit. Gruaja hapi cesmën e oborrit dhe i la këmbët nën ujë. Currilat kapërcenin këmbët dhe rridhnin drejt kopshtit të mbjellë me lule dhe zarzavate. Nata ishte krejt e shurdhër dhe nuk dëgjohej asnjë zhurmë tjetër përvec gurgullimës së ujit. Kishte nisur të dremiste kur

u dëgjua përsëri ulurima e Davidit dhe angullima e qenit.

Këmbët i ishin bërë copa akulli. Klithma dyshe

u përsërit dhe dy herë të tjera, pastaj u zbardh.

E sëmura kishte rënë më në fund në qetësi. Fytyra i kishte marrë pamjen e foshnjës së sapolindur, dicka e mishtë, e kuqe, pa forma të përcaktuara qartë.

Cezma kishte mbetur e harruar hapur. Uji kishte kapërcyer kopshtin dhe kishte marrë rrugën.

Dea dha shpirt të premtën në darkë. Zonja plakë sapo kishte dalë nga dhoma kur Davidi e tërhoqi prej krahu dhe e largoi që aty.

-Mos ulurij se i kthehet shpirti,- tha.

Pas pak minutash, ajo nuk ishte më njeri, po një gjë e stërmadhe e mbështjellë me carcaf të bardhë.

Ja zbuloi fytyrën. Më në fund, pas dy vjetësh, po flinte

qetësisht. Paqja kishte rënë mbi mollëza dhe dhe drita ia tregonte lëkurën të tejdukshme. Buzët kishin filluar të mernin ngjyrë vjollcë.

-Shihe dhe sonte se nuk ke për ta parë më, - tha Davidi.

U ngrit ngadalë për të mos prishur qetësinë e të vdekurës. Mori lule nga kopështi dhe ia vuri anës kokës.

Koka iu anua pak. Nuk guxoi ta prekte.

U mbeshtet në supin e Davidit. Qepallat u rënduan dhe u mbyllën.

-Të këputi gjumi.

Ajo po i fliste.

-Do të vish ndonjëherë?

-Do të vij kur të flesh.Do të të ruaj gjumin...

Gjumin... gjumin...

Davidi e shkundi.

-Mos fli...duhet të rrimë zgjuar sonte...është hera e fundit që e shohim...

Gruaja e pa me vëmndje në fytyrë. E vdekura lëvizi. Kishte një dritë të cuditshme që i përshkoi gjithë trupin. Ndjeu humbje peshe dhe fytyrën e saj që i afrohej vazhdimisht.....

Kur e përmëndën, pa veten në shtrat krejt të lagur.

Nga dritarja dukej arkivoli i madh i kuq.

Zonja plakë ishte ulur në mes të dhomës dhe vajtonte duke ngritur duart drejt qiellit.

-O bijë, ike natën o bijë, e le nanën vetëm o bijë, pse se more nanën me vete , o bijë...

Kishte prush nën kokë dhe flohtë. Ndjehej si një foshnjë

e braktisur. Dea kishte shkuar duke e lënë krejt të vetme në gjithë atë botë të stërmadhe, të pakuptimtë.

-Unë nuk jetoj më....

Palina e pa me cudi.

-Po ti flet, flasin të vdekurit?!

Zonjës plakë iu duk se kishte brenda vetes dy

dy qënie, një vajzë të vogël, imcake që qante fatin
që e kishte degdisur në djall, të vetme, dhe një grua
plakë që pinte

duhan me djallin për të mbytur trishtimin.

Rrinte shtrirë me krahët e kapur tek anët e
shtratit. Cigarja digjej pa u pirë dhe hiri pikonte
mbi qafën e zbuluar. Tymi përshkonte krejt trupin
me një ledhatim djalli që i kallte krupën. Ajo dhe
hija e degëve të lules së dhomës përplaseshin me
njëra-tjetrën duke krijuar një

lloj qielli me forma të lëvizshme.

Përplasja e tyre përfundonte në trupin e saj, e
njëtrajtshme si mallkim mesnate.

-Mos e pafsh në ditë të bardhë,- thoshte
mallkimi...

Ndjehej e gozhduar nën kryqin e mallkimit.
Shtrati tallej hidhur duke i ofruar ngrohtësinë e
harbuar të ajrit të nxehtë ndërsa sytë përpëliteshin
në mes të fytyrës duke u lavjerrur midis tymit dhe
hijes.

Duart lanë për një cast mbështetjen dhe u afruan
drejt hijes.

Degët e lules ranë mbi krye duke pikuar copëza
lotësh të

qulltë dhe pa formë. Tymi e pa me trishtim.

-Ti di vetëm të humbësh.

E hodhi tymin mbi dysHEME. Era e zjarrit
përhapej rreth këmbëve të zbuluara me një erë
hakmarrëse që ngjitej drejt trupit ngadalë-ngadalë.

Lisi shtyu derën me putra dhe angulli

dhimbshëm. Tymi po dilte jashtë bashkë me të
ndërsa copëzat e luleve kishin

rënë mbi të kaltrën e syve.

Dea kishte dalë nga mermeri dhe ishte ulur në
shtrat.

-Të pata thënë se do të vij, ja erdha.

-Kam prush tek këmbët,-pëshpëriti zonja plakë
ngadalë.

Ajo pa me trishtim këmbët e gruas.

-Ti i vrave lulet.

-Jo, ato më vranë mua.

Dea qeshi:

-Nuk vriten lulet, lulet puthen.

Kur të duash të vish me mua, më thirr. Do të vij
të të marr, po jo tani...tani...

Lotët e Lisit puthnin këmbët e zonjës plakë duke
shuar zjarminë.

-Ti më pate premtuar se s'do ikësh kurrë-,
thoshte gruaja me një zë të largët si jehonë guvash.

Currili i cesmës së oborrit rridhte i patrazuar
nëpër tokë të brishtë ndërsa ajri i lagësht i syve të
gruas lagte lulet dhe zarzavatet e kopshtit.

Palina hyri pa zhurmë. Zonja plakë iu afrua
zjarrit dhe për herë të parë pas asaj nate te
lodhshme, deshi të dremiste. Dhoma i ngjallte
trishtim dhe vetmi.

-Palina, merr dru te tjera dhe silli tek vatra, -

tha ngadalë.

Palina hapi deren pa bere zhurme, hodhi drutë afër vatrës dhe një paketë cigaresh bosh në zjarr.

Gruaja u kujtua që nuk kishte më cigare.

Vështroi me trishtim muret, shtratin, dollapin me pasqyren e thyer.

-O zot,- tha me vete,- nje ikje nuk eshte fundi i botes,

por është gjithmonë fundi i dickaje...

Te kujtohet, i kishte thënë Davidi vite më parë, ate mengjes qe erdhe heret dhe une isha ende ne gjume, ti kishte ftohte dhe u mbeshtolle e gjitha pas meje....e ndjeva pergjumshem qe kishe ardhur dhe ...te desha...o zot sa te desha...ty qe ne ate cast dridheshe nen peshen

e trupit tim...ti qe ishe aq e brishte, e vockel...

Palina hodhi dru në zjarr. Rreshtoi kukullat mbi divan, iu veshi fustanë të rinj dhe nisi ti krihte duke kënduar.

-Ma jep krehrin Palina, - tha gruaja, - do të t'i kreh flokët si të nuses së Butrintit...

Vajza vrapoi duke gugatur nëpër dhomë, mori krehrin, u pa një copë herë në pasqyrë, pastaj pa me bisht të syrit nusen e mermertë dhe u ul në stolin e vogël të drurit.

Perëndesha i kishte sytë të lagësht....

NUSJA

Ajo qëndronte në mes të dhomës, në këmbë, e

gjatë, me flokë të derdhura mbi supe. Rreth e qark zhurmë dhe njerëz që flisnin me zë të lartë.

Ajo, që të gjithë ia kishin harruar emrin dhe e thërrisnin “nusja”, nuk fliste asnjë fjalë. Vështronte me kujdes gjithë njerëzit dhe pastaj fiksonte sytë në një qoshe ku ishte ulur vetëm, një burrë që nuk i binte askujt në sy.

-Kush është ai atje?, - pyeti njëra nga hallat, pa marrë

përgjigje.

Nusja e kapi me vështrim pyetjen dhe ktheu përsëri shikimin tek njeriu i vetmuar. “Sikur të kisha mundësi t’ia hiqja gjithë atë bojë nga fytyra”, mendonte ai.

Nusja e kuptoi. “Nuk e kam vënë vetë bojën...”, tha me vete dhe vuri buzën në gaz.

Hallat u ngritën të kërcenin duke tundur me vështirësi vithet e trasha, nën një muzikë që ngjante më shumë si muzikë rome.

“Po martohesh ë?”, e pyeti shikimi i tij.

Nusja uli sytë. “Të pata thënë se më pëlqen të martohem njëherë”.

Sazexhinjtë filluan një këngë të vjetër ku i këndohej nuses “me sy të zinj dhe faqe pjeshkë”.

“Ti i ke sytë ngjyrë ulliri dhe lëkurën e bardhë”, tha vështrimi i burrit.

Nusja u skuq. “Sa do të doja të mbështetesh në krahun tënd tani dhe të të puthja ngadalë, ngadalë, në buzë, në

sup...”, mëmëriti.

Burri u mbështet fort në shpinën e karrikes. Gratë po dihatnin duke fshirë djersët. Ai i bëri një shenjë me hundë. “Uf çfarë ere”.

“Ty të pëlqente aq shumë aroma e trupit tim”, mendoj nusja.

Burri kërkoi një gotë ujë. E piu si i etur dhe ndezi cigaren.

“Më jep një cigare”, tha vështrimi i nuses.

“Jo, nuset nuk pinë duhan”.

Dikush i tha të ulej. Ajo mblodhi me një dorë fustanin e

gjatë ngjyrë bore dhe u mbështet në shpinë të kolltukut.

“Ishe më e bukur pa këtë fustan”, tha burri.

Nusja e pa me koketëri. “Unë e di që jam më e bukur se kurrë sonte”.

Ai u trishtua. Këputi fshehtas një gjethe nga lulja përbri dhe i bëri me shenjë: “ti je gjethe e këputur”.

Nusja filloi të qante.

-Mos e bëni për të qarë se i prishni tualetin, - tha halla e madhe.

Sazexhinjtë filluan t’u binin veglave me të madhe. Pothuaj të gjithë u ngritën të kërcenin. Ai nuk mund ta shikonte më. Para syve i rrotulloheshin këmbë dhe vithe njerëzish.

“C’do ti këtu, ky nuk është vendi yt, ti duhet të ishe në krahët e mi tani”, tha ai.

Nuses i ra të fikët. Hallat u sulën ta ngrinin. E lagën me ujë dhe e përmendën.

-Kujdes, se po vijnë, - bërtiti dikush në koridor.

Një tufë njerëzish hynë me zhurmë. Dhëndri u ul pranë nuses duke buzëqeshur. U buzëqeshi fotografëve, hallave, kushërinjve dhe burrit me fytyrë të ngrirë.

“Trap”, shau burri me vete, “nuk di as të hapësh dhëmbët”.

Nusja fshiu ballin. I bëri me shenjë dhëndrrit të ulej dhe kërkoi me sy atë.

Hallat filluan përsëri të këndonin. Nusja u ngrit papritur dhe eci me hapa të shpejtë drejt derës.

-Ku shkon moj?, - bërtiti halia e madhe.

Nusja shkoi deri tek pragu dhe u tret ngadalë, me duart që i rrëshqisnin tek shtyllat e derës. Në prag mbeti një re e bardhë fustani dhe një tufë flokësh që mbuluan dyshemenë e shtruar me dërrasa.

Hallat ngrinë. Burri u çua dhe eci me hapa të vegjël drejt derës. U ul në gjunjë dhe ia ngriti kokën nuses. I fshiu ngadalë fytyrën, sytë, buzët...

“Shkojmë e vogla ime”.

Nusja ngriti me mundim kapakët e syve dhe vuri buzën në gaz.

Burri e ngriti në krahë dhe eci pa kthyer kokën pas.

Sazexhinjtë panë me çudi rreth e qark, pastaj ia nisën zhurmës me veglat e lyrosura nga mishrat.

LYPËSI

Lypësi ishte mbështetur pas murit gjysëm të

rrëzuar dhe po dremiste. Ora e kishte kaluar me kohë dhjetën dhe njerëzit në rrugë ishin rralluar shumë.

Lypësi u zgjua nga të ftohtët dhe tërhoqi pallton e vjetër me kapuc. Pa rreth e qark një grimë dhe u cua me mundim. Mblodhi një grumbull plehrash dhe letrash të lyrosura dhe i afroi tek cepi. Kërkoj me sy shkrepësen duke kthyer xhepat e palltos.

-I cmendur, - mërmëriti, - ke harruar shkrepësen në atë lokal të helmuar....

Priti një copë herë se mos kalonte ndokush.

-S'kam kërkuar kurrë shkrepëse... - tha me vete.

Një burrë gjysëm i dehur u ndal një çast, nxori një qindarkë të lyrosur dhe ia hodhi lypësit në gjunjë.

-Shkrepësen, vetëm sa të nder zjarrin, - tha lypësi.

Burri u ngërdhesh. "Dashke edhe shkrepëse...."

Lypësi nuk foli. U mblodh përsëri me pallton, duke futur

gjuntë në kindat e saj dhe prit.

Një mace e zezë korb kaloi me shpejtësi, duke mjaullitur si e marrë. U afrua një moment tek plehrat që kishte grumbulluar lypësi, u mori erë dhe i shtyu me putra.

-Edhe ti...!, - tha lypësi me trishtim.

Macja ngriti putrat lart për tu mbrojtur ndërsa lypësi i bëri me shenjë të shkonte.

-E marrë, - mërmëriti.

Një makinë frenoi me zhurmë dhe macja shpëtoi

për pak. Një hije me kostum ngjyrë ulliri doli me hapa të fortë dhe pas tij një e qeshur gruaje. Lypësi ktheu kokën me cudi. Hija i hodhi një kartmonedhë të kuqe ndërsa gruaja një tufë biskotash që u thyen me zhurmë në trotuar.

-Më jepni një shkrepëse, - tha lypësi me zë të mekur.

Gruaja qeshi me të madhe.

-C' do të ngrohë ky....

Burri e shoqëroi me të qeshura të forta që çanin natën dhe e tërhoqi në makinë. Lypësi u mbledh në pallto. Pika të mëdha shiu ranë me rrëmbim në xhepat e shqyer.

Pas pak nisi përsëri të dremiste. U zgjua në mesnatë nga angullima e një qeni të madh, me kocka të dala, që përvajej duke lëpirë më gjuhën e gjatë dhe të kuqe pallton e vjetër.

Lypësi shtriu një rënë anë të palltos dhe e ndihmoi qenin të shtrihej. Qeni dihati pak dhe e zuri gjumi.

-Po ngrohemi të dy..., - tha lypësi me vete, duke ndjerë frymën e ngrohtë të tij. Tërhoqi ngadalë kindat e palltos dhe u mbështet në trupin e madh të kafshës.

-Të kishim pasur një shkrepse....

Qeni u rrotullua në gjumë dhe vuri një rënë putër në qafën e lypësit. Ai ngriu.

-Sa vjet kam që nuk më ka prekur kush....

Qëndroi ashtu deri pak para agimi. Qeni ngrohte njeriun dhe njeriu qenin. Në agim, të dy u cuan instiktivisht nga thirrja e dhimbshme e një zëri që

nuk kuptohej se nga vinte dhe cfarë ishte.

-Lisi, Lisi...

Lypësi pa një figurë të përcudnuar gruaje, veshur me fustan, pantallona, pallto, triko, corape, këpucë të shqyera, me një tufë qirinjsh të ndezur në dorë. Qeni gati e shqeu pallton e vjetër të lypësit. Vrapoi për t'i dalë përpara gruas, por ndaloi në moment, duke parë me sy të lëngët lypësin.

Kishte mbetur mes të dyve. Gruaja u afrua ndërsa lypësi qëndroi në vend i shtangur, duke parë atë grumbull rrobash dhe mishi, nën dritën e qirinjve. Ajo e ngriti qenin e madh në krahë dhe eci me hapa të ngadaltë drejt murit të shembur.

-E kam kërkuar gjithë natën, gjithë natën....

Lypësi nuk foli. Hapi pallton, shtroi kindat e saj në tokë dhe i bëri shenjë gruas dhe qenit të uleshin. Gruaja vendosi qirinjtë përpara këmbëve dhe i vuri flakën grumbullit të plehrave. Qeni u shtri në mes dhe zgjati putrat drejt zjarrit.

TREGIM PËR TË MËDHENJ

Në shtëpinë e vjetër kishim një qen me emrin Lisi. Kishte një shtëpi të vogël në fund të kopshtit, afër derës dhe ishte i lidhur me zinxhir hekuri rreth qafës.

Lisi më priste gjithmonë tek dera. Zgjaste kokën drejt meje, më lepinte duart, këmbët dhe kuiste dhimbshëm. Atëherë, ia hiqja zinxhirin dhe e

lëshoja. Këto ishin të vetmet ditë dhe netë të lirisë së tij. Vraponte si i cmëndur, zdhukej për orë të tëra dhe kthehej natën vonë me ndonjë mikeshë të turpshmeqë e ndiqte pas.

Prindërit e mi ulërinin, mbyllnin derën që të mos shihja skenat e "turpit" po Lisi nuk cante kokën. Pas gjashtë muajsh në lagje lindnin këlyshë të rinj dhe Lisi im bëhej babai i njeqind a dyqind këlyshëve, kush e merte vesh.

Afër shtëpisë së Lisit ishin dy fiq të medhenj, me krahë të trashë, të shtrirë mbi taracë që kryqëzoheshin duke krijuar një si karrige me rrush sipër. Ai ishte vëndi im i preferuar ku lexoja, haja dhe hetoja c'bëhej përreth.

Nga karrikja e fikut ngjitesha tek kumbullat përreth, merrja kokrrat më të mira dhe i rreshtoja në një degë që të thaheshin.

Poshtë dukej pusi që ujiste kopshtin ose bacen, sic i thoshim ne. Pompa ulej e ngrihej me zhurmë dhe uji i akullt rrëshqiste mbi oborr duke krijuar pellgje balte ku llapacitesha gjithë ditën. Herë pas here dëgjoheshin këngë pulash që lajmëronin mbërritjen e vezëve. Atëherë zbritja duke u kacavjerrë si mace nëpër trungje, merja për të ngrënë dhe kthehesha prapë në karrike.

Të njëjtën gjë bëja edhe kur vinin mysafirë që nuk i kisha për zemër.

Pemët e tjera anash gardhit më linin të shihja çfarë behej në shtëpinë komshi. Isha deshmimtare e shenjave që i bënte Nina komshiut përballë,

madje kisha mësuar edhe shenjat, një ngritje supesh do të thoshte se në shtëpi kishte njerëz dhe ajo nuk dilte dot, dy gishta do të thoshin se takimin do ta bënë në orën dy, gishti i tundur majtas dhe djathtas kishte kuptim mohues.

Nina nuk do të shkonte në takim.

Një ditë, në fakt, një mbrëmje, i pashë edhe duke u puthur. Nina shtrëngohej pranë tij sa nuk arrija të dalloja çfarë bëhej. Pastaj i bashkonin buzët dhe i mbanin ashtu për minuta të tëra. Një herë kujtova se Nina ishte sëmure dhe ai po përpiquej ta ndihmonte. Një ditë e pyeta Ninën. Ajo e shkreta u skuq dhe më zgjati një ftua të verdhë (vdisja për ftonj dhe nuk kishim as në shtëpi).

-Mos i thuaj njeriu.

-Je sëmure ?, e pyeta unë.

Nina qeshi dhe më zgjati dhe një ftua tjetër.

-Jam.Kam rënë në dashuri.

U cudita. Nuk kisha dëgjuar kurrë të sëmurej njeriu nga kjo lloj sëmundje. Pastaj e kuptova. Ishte sëmundje komshinjsh, por nuk e kuptoja pse e fshihnin këtë lloj sëmundje.

Nina më tha se ishte sëmundje e keqe dhe s' duhej të merej vesh.

Unë i dhashë fjalën se s' do t'ja thosha asnjëri, aq më tepër që Nina më premtoi se do më jepte ftonj prapë.

Në fakt më dha ftonj derisa u martua, jo me komshiun, po nejtë.

Kur u martua Nina, unë isha bërë e madhe.

Tek karrikja vinte herë pas here edhe vëllai im, po ai nuk i donte ftonjtë dhe unë nuk ia lija vëndin kur ishte

Nina sëmurë dhe e shëronte komshiu. Njeherë që e lashë, ai i tha mamit për çfarë pa dhe u bë një sherr që o zot, o zot.

Mami im dhe mami i Ninës kishin dalë në dy anët e gardhit dhe po pinin kafe. Mami im e ftoi mamin e Ninës nga ana jonë e gardhit për t'i treguar punët që kisha bërë unë (kisha palosur jorganin tim dhe e kisha cuar në vënd). Mami im kishte pastruar dhe shtëpia ndriconte e gjitha. U ulën të dyja me mamin e Ninës poshtë fikut, dhe po bënë muhabet. Unë isha atje sipër, tek karrikja bashkë me vëllain. Ai po hante kumbullat e thara duke bërë grup grup. Mami im po qeshte atje poshtë dhe po i thoshte mamit të Ninës që unë kisha filluar të rritesha.

-Kanë filluar t'i dalin ato, - tha mami im.

Zbrita poshtë duke u kacavjerrë si zakonisht dhe një krah i fustanit u kap tek dega e fundit. Derisa zbrita poshte, fustani ishte ndarë përgjysëm, një copë në trup dhe një copë varej tek pema.

Mami u tërbua. Unë ia dhashë vrapit, hyra në shtëpi dhe mbylla derën. U zhvesha shpejt e shpejt dhe veshi fustanin me lule të vogla.

Pastaj dola nga dera mbrapa dhe u afrova ngadalë pas shpinës së mamit për tek mami i Ninës. Mami më pa, por nuk më ngacmoi.

Mami i Ninës më puthi fort tek faqja, pastaj më

pyeti:

-Cfarë klase do të shkosh sivjet?

-Te e dyta.

-Me cilën mësuese?

-Me atë që kakaris.

Nuk e keni idenë si u bë mami im. U sul të më kapte prej flokësh, apo si kisha të gjata...po mami i Ninës nuk e la. Po të më kishte kapur do të kisha përfunduar në banjo deri në darkë.

Kur u ul mami prapë tek vëndi, unë për ti bërë qefin mami të Ninës i thashë që Nina më jepte ftonj të verdhë.

Mami i Ninës u kënaq, po vëllait tim që vazhdonte të rrinte atje lart, nuk iu durua pa folur:

-I jep ftonj që të mos tregojë se Nina është sëmurë,-tha.

Mua më erdhi inat.

-Nuk e bëj për ftonj po për Ninën se e shëron ai me buzë.

Nuk ua tregoj dot si u bë fytyra e mami të Ninës. Nuk pyeti kush,po më zbriti nga prehri dhe i tha mami tim.

-C'është kjo moj grua?

Mami tim nuk ia bëri syri tërr. Drejtoi trupin dhe i tha:

-Pyet cupën tënde që e shërokan nga buzët.

Mami i Ninës u cua në këmbë, kaloi portën e gardhit dhe u vu në pozicion në anën tjetër.

-S'ke turp. Flet për cupën time që nuk i dëgjohet zëri...

-Po shihet!-ia ktheu mami im.

Unë u habita. Mami im nuk kishte parë gjë.

Njëherë fliste mami im, njëherë mami i Ninës, derisa zërat u bashkuan dhe nuk merej vesh çfarë thuhej. Unë hoqa copën e fustanit që kishte ngelur tek pema dhe dola në rrugë. Kalamajtë ishin mbledhur dhe dëgjonin.

-Kush do të fitojë?,- pyeti vëllai i atij komshiut që shëronte Ninën.

-Mami im,- thashë unë.

-Mami jot është ngordhalaqe,- ma ktheu ai.

Unë u tërbova. E gjuajta me grusht te barku, po ai mi kapi bishtalecat dhe mi tërhoqi fort. E di sa më dhëmbi koka...

Pastaj erdhi vëllai im me gjithë Lisin. Kur pa Lisin, ai m'i lëshoi flokët dhe ia dha vrapit. Edhe kalamajtë e tjerë e kishin frikë Lisin, kështu që nuk folën më.

Kur mbaroi muhabeti tek gardhi, mami im dhe mami i Ninës u kthyen prapë tek pusi për të pirë kafënë.

Unë u cudita prapë.

Ne kalamajtë, kur ziheshim, mbanim inat,pështynim tek gishti i vogël dhe nuk flisnim, kurse ato u pajtuan menjëherë.

Mami im më tha pastaj se ajo dhe mami i Ninës nuk ishin zënë si ne, po "kishin bërë muhabet".

Unë nuk e pyeta më, po që atëhere nuk i besoj më të mëdhenjtë kur zihen. Gjithmonë më duket se bëjnë "muhabet".

QESHJA E DJAJVE

Ndjeva nje renie therese si e murit te kalbur qe shgerryhet neper qoshe nga vitet e gjata te bashkejeteses me lagashtiren. Nga maja e dollapit kishte rene thesi i madh i plackave.

Mimi hapi syte pergjumes.

-Erdhi macja?

-Jo shpirt. Fli.

Ai u rrotullua ne krahun tjeter duke hedhur poshte mbulesen.

Dritarja e hapor mbulohej vetem me perden e tylte qe perkundej sipas ritmit te freskise se nates.

Ora ne mur i kishte bashkuar akrepat tek dyshi. Ishte e katerta here qe zgjohesha ne mesnate. Nje here me kishte zgjuar perplasja e karkalecave ne perde ndersa heret e tjera Mimi qe pyeste per macen e zhdukur qe prej dy javesh.

Im ate e kishte nxjerre macen ne rruge, diku larg shtepise dhe qe atehere, askush nuk e kishte pare me.

-Nina ... Nina..

I vogli ishte zgjuar prape, sic duket nga te ftohtet. Zgjata doren drejt mbuleses, por nuk e kapa dot. Mimi u cua pa pare ku shkelte dhe u fut ne shtratin tim.

-Me bej xhan xhan qe te me zere gjumi.

Shtrengoi duart rreth trupit tim dhe mbylli syte.

Nata ishte e kthjellet dhe kolonat e ballkonit dukeshin si te lara ne argjend. Drita e zbehte binte neper ane duke krijuar nje imazh hyjnor, te pertejbotshem.

Hija e maces u shfaq nen hijen e kolones anesore si dicka e stergjate. Syte e bukur vezullues iu afruan dritares.

-Nina...Nina...

Macja mjaulliti dhimbshem.

Mimi terhoqi mbulesen, futi koken nen jastek dhe kerkoi dicka pergjumshem.

Kanatet e dritares levizen nga era.

Macja buzeqeshi dhe musqet iu bene si bistake te holle, pemesh.

-Mimi eshte i bukur si kotele...

Fjala u perplas me kanaten e dritares qe u perplas me zhurmë. Era ishte bere si e cmendur. Macja u mbajt tek perdja, por tyli nuk e mbajti peshen dhe gjithshka u permbyes me rrapellime.

-Nina. Cfare ka?

Macja u drodh.

-Ik, ik shpejt...

Dera e dhomës u hap me tërsëllëmë.

-Nina, kush është aty?

-Askush.

Macja ishte strukur poshtë perdes.

Im atë sgjati dorën dhe e tërhoqi nga veshët. Ajo mjaulliu dhimbshëm.

-Të lutem, lëre...

-Pusho!

Ai doli tek dritarja me macen që e mbante për veshësh. U mendua një sekonte dhe e lëshoi pingul mbi kolonë.

Ulurima e maces u bashkua me klithmën e Mimit.

U dëgjua një zhurmë e thatë dhe një mjaullimë e fundit cfilitëse.

Drita e hënës binte mbi sytë pakës të hapur. U përgjunjëm të dy me Mimin duke e përkëdhelur.

Perpeliti koken ne duart e Mimit dhe mbeti me sytë drejt qiellit.

Nata ishte e vakët si manastir i stërmadh.

MONOLOGU I TË CMËNDURËS

Ti je një foshnje e urtë që fle në shpirtin tim ...dua të të mashtroj për të harruar...ti ke vdekur në zemrën time por unë nuk të kam vrarë ende...më vjen cdo natë në ëndërr dhe më lodh...bota rrotullohet bashkë me mua dhe dielli nuk më lë të të shoh...këtu thonë se natën nuk ka diell, por unë e ndiej, ai më pengon të të shoh ty...mbrëmë nata u mbyt në dritën e vet kurse dielli ishte lidhur me zinxhirë dhe qante me lotë të valuar...vetmia është e keqe...më thotë se askush nuk i pengon më ëndërrat e keqia të vijnë dhe të prishin gjumin...shtrihet mbi mua dhe më tregon qiellin e zi...gjithmone shoh fantazma nusesh dhe foshnjash që më ruajnë shtratin...më thonë që jam

Shpirti lakuriq

cmëndur...vetëm ti nuk më thua që jam
cmëndur.....kam frikë nga buzët e tua...janë të
ëmbra...e ëmbra i ngjan vdekjes...

KUPOLA E MALLIT

Nen kupolen e vetmuar te mallit endemi te dy,
ti rrugicave te nates, une kodrave te dites,
stina e re perplaset ne shpirtin tim te lodhur,
stina e vjeter germon shpirtin tend te virgjer;
fytyrat e bukura jane tretur prej kohesh brenda nesh,
therrime amforash te dashurive te masakruara gjejne
fajdexhinjte,
nje dashuri vlen vetem nje qindarke,
dy dashuri baraz me nje gijotine,
tre, kater, pese dashuri, nuk kane me njesi matjeje....
Nen kupolen e vetmuar te mallit endemi te dy,
ti rrugicave te nates,
une,
kodrave te dites....

IKJA

E ndjej ikjen tënde,
fluturim drejt qiellit të humbjes,
vetmi e cmëndur sfilitëse
që vajton gjithë të vdekurit,
vec teje...
Cdo gjë është në rregull,
bluza vetëvrarë në varëse,
filxhanët të përmbysur në pjatëza vajtojne njëri-
tjetrin,
dera hapet e mbyllet me kuisje qeni
qëlluar me gurë rrugësh të varfra,
zilja e telefonit bie gërryshëm,
më gërryen trurin,
lamtumirë i gërryeri im i dashur,
të pres në ferr nesër në ora 200000.....
Kaq mëngjese luajtëm me vuajtjet e njëri tjetrit
duke u tallur me dashurinë,
kaq mëngjese fyem vetveten
duke folur për harrim,
tani,
ne fortesën e mishit e të gjakut
dashurine e pret kryqëzimi,
thërrimet e shpirtit bien të lodhura mbi dru që digjen
ngadalë,
në vatrën e kujtimeve,
trup i piqet në diell zhuritës dhe flakë,

zemra mbyllet përjetësisht në dimër,
mbretëri e shkalluar,
këmbët mbështjell me dhimbjen time të ngrohtë,
sytë e mi fsheh prej syve kënetat,
bien muret e kalburat,
catia dhe djajtë në vathën e deleve qeshin,
po thërmohen të gjitha në thërrime dashurie të
marrë.....
Hekurat ndryshken dhe nuk më mbrojnë dot më nga
bota,
lotët kthehen në kërcej akulli,
vajtocat këndojnë kujtimin tim me zë kukuvajke,
në hirin e zjarreve të shuar kaherë,
lindin djaj të kuq në pyll fantazmash,
netë të mugëta,
me një qiri që vetmuar varreve.....
Jam tretur në vesën e trëndafilave të bardhë,
kam flijuar veten në themelet e dashurisë,
jam varur në litarët e shiut të lotëve,
liqenet e syve m'i ktheve në akull ti...
Tani në krevatin e syve të mi,
mbuluar me vello qerpikesh,
si një cantë e vjetër shpine më varesh mbi shpatulla,
fshihesh në vdekjen e lagësht të luleve...

AJO TOKË ËSHTË E IMJA

Ua them të gjithëve,
kufoma,
engjëj,
gurë e drurë,
ajo tokë është e imja!
Nuk mund ti harroj klithmat,
nji grimë varr, pak dhe,
ikje nëpër muzg, nëpër natë,
turma ushtarësh që klithin vdekshëm,
ndjellin vdekje...
Cmenduni,
tokë e qiell bashkë,
ajo tokë është e imja;
eshtra malli tretur rrugëve mërgimtare,
gjaku im i ngjizur,
derdhet kodrinave të mbetura një shekull pas,
braktisur nga zoti,
lotë të larë në një grimë hëne tallëse,
ndricim i thekshëm flokësh të thinjur,
pa klithmë lindjeje,
këmbka të vockla që capiten e vriten,
në gurë malesh te rëndë,
shpirt-shkukur,
femije lindur në muzg,
toka ime,
krishti me vuajtjet e botës mbi shpinë...

UNË GJITHMONË KTHEHEM

Do të kthehem shpirt!
Kur të jesh vetëm dhe pylli të zhytet në natë,
do të jem aty,
kokën tënde do ta vë të prehet në zemër, sythet që
flenë
nëpër drurë do të behen shtrati yt,
mos ki frikë nga egersirat, duart e mija mbysin natën
dhe friken,
jam unë me e fortë se guri i shpellës së ngujimit,
lëre të vdesë të cmëndurën flokëshprishur,
do të endem unë shtëpizave ne agim,
ia gjej strehën e fundme,
shtëpizen ta ndërtoj cdo natë me flokët e mi,
sytë i bëj dritareza për botën tënde vogëlushe,
më prit,
kthehem dhe trishtimin e kthej në furtunë,
botën e bëj të cmëndet,
mbështetu në marrinë time,
unë gjithmonë kthehem,
shpirt....
dashuria e tokës është e pamjaftueshme,
më jep etje,
ndjehem e shkretëtirtë...

RRUGA

Rruga zgjatet rrënjëshkullur drejt kënetës së
kraharorit,
baltovinë barishtesh të kalbura,
të vrara në rrjedhën funebër të kohës...
me bisturi vizaton figura prerjesh,
pikturon trupin me maja thikash,
rruga krahet i përdor sic përdoren prostitutat,
në një klithmë epshi të humbur në një kanal minjsh,
shtrihet në hapësira duke varrosur gjurmë braktisjesh
dhe gjaku,
nën të janë jetët,
sinonim i një kepuce gjysëm të tretur,
kocka të vrara, gurë të marrosur ngjyrë dheu,
mbi rrugë është vdekja,
kufij fryme dhe mishi,
tundim minutash me emër miklues,
rruga është unë,
përkohmëri egzistencë,
përjetshmëri shpirti,
rrënjë të fjetura, rizgjim brezash të harruar,
kohë e masakruar në shpatullat e zotit...
rruga është gjallja dhe ringjallja ime...

O ZOT KJO NATË SONTE

O zot kjo natë sonte,
dritëz e mjegullt para agimi,
e prekshme si frymë drite,
e paprekshme si ujë që rrjedh nëpër duar,
humbet krahëve të butë të mjegullës,
më cmëndi kjo natë sonte...
e bukurë si sytë e humburë në krua...

VALLE E CMËNDUR

Në vallen e cmëndur të ujqve vërtitemi,
vdesim në kafshime përbindëshash
gjarpërinj,
në gracka të kalbura rrëshqasim,
me helm ushqehemi,
me minj!
Me krye,
pa krye
këlthasim,
flokët i lidhim në shtrat,
mure të lagështa ndërtojmë
me lumturi të dhuruar,
qeshim,
marrëzisht,
me shkak!
Zinxhirë këpusim,
qëllojnë atë që foshnjën
mban në bark,
foletë e zogjve këpusim
si yje të humbur,
tërbimshëm qeshim,
natyrisht me shkak!

TRISHTIMI I FUNDIT

Dashuria tani është mundim,
sytë janë zgavra të thata drurësh,
lotët pellgje të ndyra balte,
trupin kam ndërruar sic ndërrohen të dashurit,
dhe dashuria duket si të brendshme të grisura,
të hedhura në djall...
toka ka humbur pikëmbështetjen,
këmbët e lakuriqta kanë tunduar
zotin e patundueshëm,
cubat kanë shkelur kraharorin,
sytë,
si hajmali kanë mbajtur copa buzesh,
më mbytën me drithma epshesh,
u dehën duke puthur kufomen time...

DHEMBJE

Është pjekur dhemja ime,
si kokrra kafeje e përtyp cdo ditë
nën ritmin funebër të humbjes,
është pjekur në plagën e hapur prej vitesh, gojë
- prishur kutërbon erë varreze,
më ka mbytur si kancer me fijëza tradhtare,
që rriten brënda qënies time,
dhëmbje e keqe,
fëmijë e rritur që tallesh me lodërzat e mia,
me ditët e pajetuara dhe netët e vdekura,
me terrin e frikës,
tani vetëm ti më ke mbetur....

SIC TE DESHA UNË

Si bishë në mish të ngrohtë dhe gjak të vaket,
si njeri ditë - mbaruar,
si dreq mbërthyer pas një grimë dashurie,
e vdekur cdo natë në mbrëmjen tallëse,
në ditën e vdekur në pyllin e largët,
shenjtëruar në kujtimin tënd të ëmbël,
harruar në një lamtumirë të flakur buzë detit,
Te desha sic di të dua vetëm unë,
rebelisht, nën thikën e shikimit tënd....

DUART E MIJA

Duart e mija janë holluar,
si brinjë të verdhë hëne rrëmojnë në sende të ndaluara,
futen përdhunshëm në skuta heshtake,
mprehin thonjë gjatoshë si dardha të athta
dhe i braktisin në kazanë të ndryshkur;
prekin trupin e një burri
pa u turpëruar nga ngrehinat,
dhe plazhet e tij buzë detit me rërë e myshk të lagësht,
gllabërojnë toka të pashkelura piratësh,
fshihen në flokë të trishtë,
dashurohen si të cmëndura me sy e qerpikë,
përkëdhelin lëkurën e butë,
të lakuar të kraharorit,
luajnë në pyje të frikshëm,
mbështjellë me ëndrra fëmijësh imcakë,
prekin butë tastierën e një vegle të cuditshme me
muzikë
ujrash që braktis folenë e zgavruar të natës,
humbasin në ankthin e zemrës time;
gishtat e mi të errët prekin plagën,
që fle dhe lëpihet prej gjuhës së kujtimit

gjuhë e trishtë që fshin dysshemetë e zotave të
pushtetshëm,
një kokëprerës duhet,
t'i presë deri në qafën e marrë
që endet si mermer statujash,
verbojnë sytë e untë të lypsave buzë trotuareve,
në prehrin e nënës i fsheh,
si në afshin e druve që digjen
digjem bashkë me to,
deri në asht të dhembjes,
përvëlur prej lotësh të varrosur në shpirt....

QAJ NËNËZA IME E GJORË

Me vranë,
nënëz, shpirt,
me tallje triumfi më copëtuan mishin
dhe gjakun ma mbollën në ëndrra,
më mbytën klithmën e fundit,
me flokët e mi bënë litarin e të varurit;
më vranë,
nënëz, shpirt,
u zhdukën në terrin e humbjes,
copat e shpirtit mi hodhën nëpër natë,
trishtimin tim vjeshtak,
bregën time,
e pinë si verë të vjetër,
mbretërisht,
u lumturuan në marrinë time,
nënës e ëmbëlth,
më dogjën në frikën e frikës,
me qirinj varresh.....

ËNDËRR NË ËNDËRR PRINCI IM

Gjethet digjen në prushe fjalësh që si thamë,
në akuj heshtjesh dridhen netët,
udhë të largëta treten mesnatave të hirta,
zgjaten...përtej jetës...
nën pemëza
të vetmuara,
kopshtet e përhumbrur nën agim të pacelë,
trupi im mjegullt shpërndarë në dritë - hije,
pa stinë,
kohë e pafund pritjeje nën sythe që celin e vyshken
pa foshnja,
fëmijë i pafajshëm që trazon gjumin e të bukurës së
patretur,
lulëza dhe zogj të kristaltë në trishtimin e madh të
botës,
puth të ëmblën e lënë vetëm në copëzën e qiellit të
xhamtë,
drithërimë perëndie në buzë të ujëta, sy këngësh,
tretesh përhumbrshëm në ëndërr, princi im...
Në terr digjet bota,
në ëndërr digjen fjalët që s'i thamë,
puthje fund netësh, lindje agimesh,
ëndërr në ëndërr princi im...

MUZG PAQËTIMI

Nën degë e gjethe fëshfërimë më vjen e shkon zemra ime,

fshihesh në mall e lot e brengë, në puthje mbetur drithërimë...

nën hënëz dritë fshehur botës, nën diell muzg paqëtimi,

kështu më shkon e vjen ndër netë, kur shpirti prehet, zë

trishtimi...

Nën dritë pemësh përpëlitet trup i drobitur prej hidhërimi,

dhe zemër e shkretë humbet në vaje, në tokë të hidhur prej mallkimit...

Vec ti, vec tij vjen nga përtej,

atje ku bota humbet botën,

më merr, më fal, më ngre, më flak, në të gjithë qiejt e përfolur....

Vec ti, vec ti vjen nga përtej, atje ku zoti humbet fronin,

më ngrin në mjegull kaltëroshe si ëndrra ime, larg e shkelur...

më puth si jetë, dhe përtej jetës ngrihem, përtej brengës, përtej mallit...

"SHPIRTI LAKURIQ"

Lindita Karadaku

Formati. 125 x 200

Tirazhi 500

Shtypur në Shtypëshkronjën e Shtëpisë Botuese

"KOHA"

**Adresa: Bulevardi "Bajram Curri" Pallatet "1 Maji"
përballë Farmacisë nr.11. Tiranë Albania**

Tel. 00355 401 21

Fax. 00355 401 22

